

VENDIM
Nr. 31, datë 20.2.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE AKSIONET E SË CILËS
ZOTËROHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE TË NGARKUAR
ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK KESH SHA PËR PERIUDHËN 1 PRILL
2017 – 31 DHJETOR 2017**

Në mbështetje të nenit 16, 19, dhe 47 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neni 10 të VKM-së 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nenin 19 pika 1 germa “c” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 20.2.2017, mbasi shqyrtoi relacionin “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH sh.a., për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- ERE, në përmbushje të përgjegjësi që i ngarkon ligji nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, në mënyrë të veçantë referuar nenit 19, germa “c” paragrafi “iii”, miraton, në përputhje me parimin e transparencës dhe duke marrë në konsideratë koston e shërbimit të ofruar, tarifat për veprimtaritë e licencuara për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik.

- KESH sh.a., me shkresën nr. 162. Prot. datë 11.1.2017, ka kërkuar rishikimin e tarifës, që të sigurojë përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen me BERZH pas miratimit të ligjit nr. 125/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë së huas me BERZH për “Planin e ristrukturimit të KESH””.

- KESH sh.a. ende nuk ka paraqitur pranë ERE-s një aplikim të saj për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 prill 2017-31 dhjetor 2017 në të cilin të parashtrojë me shifra, argumente dhe analizë ekonomike nevojën për të ardhura të mjaftueshme për veprimtarinë normale dhe arritjen e pikësnyimeve të saj.

- Me qëllim që të përcaktojë sa më drejt çmimet e shitjes së energjisë elektrike tek klientët fundorë, ERE duhet t’u referohet kostove reale për të gjithë aktivitetet e rregulluara, përfshirë këtu edhe atë të prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria OSHEE sh.a., në aplikimin e saj për tarifë për vitin 2017, nuk ka kërkuar ndryshim të çmimeve për klientët fundorë, por rialokim të kostove për nivele tensioni.

- Në shkresën nr.682 Prot., datë 31.1.2017 MEI shprehet se “Për të përmbyllur me sukses këtë proces, vlerësojmë se është e nevojshme kryerja nga ana e ERE-s e një analize të drejtë të të ardhurave të kërkuara dhe kostove reale të operimit për secilën prej shoqërive publike, KESH, OST dhe OSHEE, me qëllim miratimin e tarifave përkatëse për vitin 2017 të cilat duhet të jenë transparente dhe të sigurojnë zhvillimin normal të aktivitetit në përputhje me kriteret që përcakton ligji dhe objektivat për qëndrueshmërinë e sistemit dhe stabilitetin financiar të sektorit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike

aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti